



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2992 prot.

Tiranë, më 31/12/2020

VENDIM QARKULLUES

Nr. 54, datë 31.12.2020

**PËR
KOMANDIMIN E ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË**

Në bazë të nenit 49 dhe 51 të Ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Kodit të Punës së RSh, të Kodit të Procedurave Administrative, të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme ...”, të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës shtetërore dhe enteve publike”, në vijim të shkresës nr. 2983 prot., datë 30.12.2020, e Administratorit të UMT, z. Andi Mahila, “Paraqitje e dorëheqjes nga pozicioni i punës”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Pranimin e dorëheqjes së z. Mahila.
2. Për të lejuar vijimin normal të punës në institucion, deri në momentin e zhvillimit të procedurave të punësimit për këtë pozicion pune, Bordi i Administrimit pasi verifikoi që znj. Alba Sako, me pozicion “Administrator i Fakultetit të Mjekësisë Dentare”, plotëson të gjitha kriteret ligjore, vendosi të komandojë znj. Sako në pozicionin e “Administratorit” të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Znj. Sako do të ushtrojë detyrën si Administrator i UMT-së deri në momentin që Bordi i Administrimit do të zhvillojë procedurat e punësimit për këtë pozicion pune.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i dërgohet për dijeni nga Sektori i Burimeve Njerëzore: Rektorit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë; Z. Andi Mahila; znj. Alba Sako; të gjithë njësisive kryesore; si dhe strukturave përbërëse (Senatit, Sektorit të Financës) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Degës së Thesarit, Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, si dhe të publikohet në faqen zyrtare të institucionit.
5. Ngarkohen të gjithë strukturat për zhvillimin e të gjitha procedurave ligjore, për njohjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

**KRYETARI
FLORIAN TOTI**

